



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

<b>Datë/a:</b>	05.07/2021
<b>Referenc-ë:</b>	07-353/04-122260/21
<b>Për/ Za/ To:</b>	“Advors Agency” SH.P.K
<b>Përmes/Preko/Through:</b>	Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	<b>Pëlqim</b>

Drejtorja për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën me nr protokoll 07-353/04-122260/21 nga “Advors Agency” SH.P.K për shfrytëzimin e hapësirës publike në sheshin “Zahir Pajaziti” me datë 01, 02 dhe 03 Gusht 2021 nga ora 18:00 deri në 21:30.

Qëllimi i kë kërkesës është organizimi i kampanjës me brendin Rc Cola dhe organizimi i tre(3) lojërave të vendosura në një tavolinë ku gjatë lojërave do të kenë mundësi të fitojnë Iphone, trotinet elektronik, Apple watch.

Drejtorja pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronë Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike me datë 01, 02 dhe 03 Gusht 2021 dhe vendosjen e një tende në sheshin “Zahir Pajaziti” nga ora 18:00 deri në ora 21:30.

**Kushtet e pëlqimit:**

- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHIP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.
- Nuk lejohet dëmtimi i pronës publike dhe çdo dëmtim eventual si pasojë e këtij aktiviteti do të jetë përgjegjësi e juaja;

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.